



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2754 Prot.,

Tiranë, më 09.11.2021

VENDIM

Nr. 3, datë 09.11.2021

**“PËR THIRRJEN E MBLEDHJES SË POSAÇME TË DREJTUESVE TË
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËR PËRZGJEDHJEN E
KANDIDATËVE PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIN E LARTË
TË PROKURORISË”**

Në mbështetje të nenit 52 pika 3, nenit 150 pika 3, nenit 48 dhe 146 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe neneve 11, 16, dhe 53 pika 2 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Nr.184 Akti, Nr. 76 Vendimi, datë 04.11.2021,

VENDOSA:

1. Thirrjen e Mbledhjes së Posaçme të drejtuesve të institucioneve të arsimit të lartë për përzgjedhjen e kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga trupa e pedagogëve, në datën 15.11.2021, ora 10.00, në ambientet e Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë me adresë: “Bulevardi Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4, Tiranë.
2. Zgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë është pika e vetme në rendin e ditës së Mbledhjes së Posaçme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONCAJ

